

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7054
E mërkurë, 22 nëntor 2023
Çmimi 0.50 €

Stoltenbergu në Beograd:
Grumbullimi i ushtrisë serbe
pranë Kosovës s'i ndihmon
situatës | FAQE 4



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OSMANI PËR DRAFT-STATUTIN E ASOCIACIONIT: KA ÇËSHTJE QË KRIJOJNË DYKUPTIMËSI, DUHET TË SQAROHEN | FAQE 5



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka folur të martën për draftin e statutit për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Ajo ka thënë se ka çështje që duhet të sqarohen sepse krijojnë dykuptimësi. Po sipas saj, mund të krijojnë probleme në praktikë. Presidentja ka thënë se që nga fillimi ka qenë tërësisht e paarsyeshme që ky draft të mos ndahet me liderët e opozitës

AKTUALE



GJYKATA LË NË FUQI MASAT
E SIGURISË KUNDËR BERISHËS | F. 2

AMBASADORI I SHQIPËRISË BËN
HOMAZHE NË PREKAZ, VIZITON EDHE
FAMILJEN E ISH-PRESIDENTIT
RUGOVA | F. 7

PILOTËT E FSK-së NISIN PROGRAMIN
RIFRESKUES TË FLUTURIMIT NË
SHQIPËRI | F. 3

EKONOMI



VËRSHIMET QË TRONDITËN
KOSOVËN, PROCESOHEN PAGESAT
PËR RRETH 2 000 FAMILJE TË
PREKURA | F. 8

KURTI: RRIJTJA EKONOMIKE KËTË
VIT PRITET TË JETË 3.8 % | F. 8

SPORT



PEJA DHE TREPÇËN SONTE
ZHVILLOJNË SFIDAT E FUNDIT NË
GRUPET E FIBA EUROPE CUP | F. 10

DY HERË BRENDA VITIT KAPLOHET NGA ZJARRI INSTITUTI I MJEKËSISË LIGJORE

PSE EDHE PAS ZHDUKJES SË MOSTRAVE TË RASTIT DEHARI NIVELI I SIGURISË NË KËTË INSTITUT MBETET KAQ I ULËT? | FAQE 3

Një zjarr i ka përfshirë disa zyra të Institutit të Mjekësisë Ligjore të Kosovës në Prishtinë mëngjesin e së martës. Ende nuk dihet çfarë mund ta ketë shkaktuar zjarrin në ndërtesën e këtij instituti. Prokuroria Themelore e Prishtinës dhe

policia kanë bërë me dije se i kanë nisur tashmë hetimet "për sqarimin e plotë të rrethanave që karakterizojnë ngjarjen". Djegia e zyrave të këtij instituti dy herë brenda këtij viti ka bërë që opozita të reagojë ashpër ndaj Qeverisë së Kosovës



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Gjykata lë në fuqi masat e sigurisë kundër Berishës

TRANË, 21 NËNTOR - Gjykata e Apelit Kundër Korrupsionit në Shqipëri ka lënë në fuqi dy masat e ndalimit ndaj ish-kryeministrit Sali Berisha.

Berisha kishte apeluar kundër masave "detyrim për t'u paraqitur" dhe "ndalim i daljes jashtë shtetit", që Prokuroria Kundër Korrupsionit (SPAK) i vendosi ndaj tij më 22 tetor. Berisha po hetohet nga SPAK-u për përfshirje në "korrupsion pasiv të kryer në bashkëpunim" gjatë privatizimit të ish-kompleksit sportiv "Partizani".

Genc Gjokutaj, avokati i Berishës, tha pas vendimit, se sërisht do ta ankimojë atë. "Do t'i shfrytëzojmë të gjitha mjetet ligjore. Do të jetë një betejë e gjatë. Do të shkojmë në Gjykatën e Lartë", u shpreh Gjokutaj. Ndërsa vetë Berisha sulmoi sërisht SPAK-un, duke e quajtur "bandën më të rrezikshme në një institucion".

Që prej caktimit të masave të sigurisë ndaj tij, Berisha ka sulmuar SPAK-un dhe Gjykatën

Kundër Korrupsionit që, sipas tij, po zbatojnë urdhra politikë. Ai nuk ka pranuar të paraqitet në SPAK sipas detyrimit, dy herë në muaj.

Ndërkaq Gjykata e Apelit ka zbutur masën e sigurisë ndaj dhëndrit të tij, Jamarbër Maltezi, nga "arrest me burg" në "arrest shtëpie".

Hetimet nga SPAK-u nisën pas një kallëzimi të dorëzuar në vitin 2020 nga Taulant Balla, tani ministër i Brendshëm. Në kallëzim theksohej se "Jamarbër Maltezi privatizoi kompleksin Partizani në mënyrë të paligjshme me një shumë rreth 100 mijë eurosh, ndërsa në këtë zonë tashmë janë ngritur disa pallate për banim. Kjo u arrit përmes vendimeve favorizuese të qeverisë së drejtuar nga Sali Berisha".

Kompleksi sportiv "Partizani", me një sipërfaqe prej 26 mijë metrash katrorë, u privatizua në vitin 2008 dhe deri në atë kohë ishte pronë e Ministrisë së Mbrojtjes.

Rreth 22 mijë metra katrorë iu



përkisnin 64 trashëgimtarëve të pesë familjeve të ish-pronarëve, mes tyre edhe Jamarbër Maltezi, ndërsa 4 000 metra katrorë të tjerë ishin pronë shtetërore. Në fund të procesit të kthimit të kësaj

prone, Jamarbër Maltezi arriti të marrë 35 për qind të të gjithë pronës, duke përfshirë këtu edhe pjesën që ishte tokë shtetërore. Sipas padisë së dorëzuar në SPAK, kjo është bërë përmes

vendimeve të dyshimta të qeverisë së Sali Berishës. Në atë sipërfaqe të përfituar, Jamarbër Maltezi së bashku me ortakun e tij Fatmir Bektashi kanë ndërtuar disa kulla.

Zyrtarët e Hamasit thonë se marrëveshja për pengjet mund të arrihet së shpejti

GAZA, 21 NËNTOR - Zyrtarët e lartë të Hamasit - grupit radikal palestinez të shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja - thanë të martën se një marrëveshje, për lirin e pengjeve nga ana e tyre dhe lirin e të burgosurve palestinezë nga Izraeli, mund të arrihet shumë shpejt.

Rreth 240 njerëz u rrëmbyen nga Hamas në Izrael më 7 tetor dhe u dërguan në Gazë, sipas zyrtarëve izraelitë.

Izraeli, Shtetet e Bashkuara dhe Katar, i cili ndërmjetëson me Hamasin, kanë disa javë që bisedojnë për lirin e pengjeve si dhe për një armëpushim të përkohshëm në Rripin e Gazës



dhe futjen e më shumë ndihmave humanitare në territorin e rrethuar. Ushtria e Izraelit është duke e

zgjerruar ofensivën e vet në veri të Gazës, ku zhvilloi luftime të ashpra me pjesëtarët e Hamasit në kampin e mbipopulluar të

refugjatëve, Xhabalia, i cili është më i madhi në tërë Gazën.

Ushtria tha se forcat e saj po e "përgatitin fushëbetëjen" në zonën e Xhabalias, në veri të qytetit të Gazës, dhe se i kanë vrarë dhjetëra pjesëtarë të grupit radikal në ditët e fundit. Ajo tha se i ka zbuluar tri boshte të tunelit ku luftëtarët po fshiheshin dhe se i shkatërroi raketahedhësit e tyre. Hollësitë e luftimeve nuk ka qenë e mundur të verifikohen në mënyrë të pavarur.

Një sulm në një spital të afërt i vrau 12 persona të hënën, kur trupat dhe tanket izraelite po luftonin me luftëtarët e Hamasit pranë tij.

Izraeli thotë se Hamasi i përdor civilët dhe spitalet si mburoja njerëzore, derisa kritikët thonë se rrethimi dhe bombardimet e pareshtura izraelite përbëjnë ndëshkim kolektiv për territorin e 2.3 milionë palestinezëve.

Më shumë se 12 700 palestinezë - dy e treta gra dhe fëmijë - janë vrarë prej që nisi lufta më 7 tetor, sipas autoriteteve shëndetësore palestineze, të cilat s'e bëjnë dallimin mes civilëve dhe luftëtarëve kur llogaritin viktimat. Raportohet se rreth 4 000 janë zhdukur.

Rreth 1 200 njerëz u vranë në Izrael, shumica gjatë sulmit të 7 tetorit, dhe rreth 240 u morën peng nga Hamas.

Kroacia thotë se dëbimi i diplomatit kroat nga Serbia e destabilizon rajonin

ZAGREB, 21 NËNTOR - Ministria e Punëve të Jashtme e Kroacisë tha të martën se vendimi i Serbisë për ta shpallur sekretarin e parë të Ambasadës së Kroacisë në Beograd si persona "non grata" i përkeqëson marrëdhëniet mes dy vendeve dhe e destabilizon situatën në rajon.

Më 20 nëntor Ministria e Punëve të Jashtme e Serbisë e shpalli Hrvoje Šnajderin person të padëshirueshëm në Serbi sepse ai "i ka tejkualuar kufijtë e normave diplomatike". Ajo nuk ka dhënë ndonjë

shpjegim tjetër.

Kroacia e ka kundërshtuar vendimin e Serbisë duke thënë se nuk i pranon "arsyet për dëbimin e një diplomati të akredituar kroat". "Vendimi i lartpërmendur i Republikës së Serbisë paraqet një hap drejt përkeqësimit të marrëdhënieve të ndërsjella, si dhe destabilizimit të mëtejshëm të situatave të ndjeshme politike dhe të sigurisë rajonale në një kohë kur stabiliteti i Evropës Juglindore është i një rëndësie të jashtëzakonshme për të gjithë Evropën", thuhet në

njoftimin e Ministrisë kroate.

Ajo tha se ndihet e shqetësuar se dëbimi i diplomatit kroat "paraqet presion shtesë ndaj punonjësve të ambasadës kroate në Beograd, i cili posaçërisht manifestohet në periudhën parazgjedhore në Republikën e Serbisë". "Shprehim keqardhjen tonë që përshkallëzimi i parashikuar i marrëdhënieve nga Republika e Serbisë në këtë kohë u realizua me një vendim drastik për dëbimin e diplomatëve", thuhet në reagimin e Ministrisë së Jashtme kroate.



DY HERË BRENDA VITIT KAPLOHET NGA ZJARRI INSTITUTI I MJEKËSISË LIGJORE

Pse edhe pas zhdukjes së mostrave të rastit Dehari niveli i sigurisë në këtë institut mbetet kaq i ulët?



Një zjarr i ka përfshirë disa zyra të Institutit të Mjekësisë Ligjore të Kosovës në Prishtinë mëngjesin e së martës. Nuk dihet se çfarë mund ta ketë shkaktuar zjarrin në ndërtesën e këtij instituti. Prokuroria Themelore e Prishtinës dhe policia kanë bërë me dije se i kanë nisur tashmë hetimet “për sqarimin e plotë të rrethanave që karakterizojnë ngjarjen”. Djegia e zyrave të këtij instituti dy herë brenda këtij viti ka bërë që opozita të reagojë ashpër ndaj Qeverisë së Kosovës. Përfaqësuesit e partive opozitare kanë drejtuar gishtin kah Ministria e Drejtësisë, duke kërkuar përgjegjësi dhe dorëheqje. Ata kanë rikujtuar edhe skandalet e tjera që kanë ndodhur në këtë institut gjatë qeverisë Kurti

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Një zjarr i ka përfshirë disa zyra të Institutit të Mjekësisë Ligjore të Kosovës në Prishtinë mëngjesin e së martës. Nuk është raportuar për persona të lënduar, sipas Policisë së Kosovës. Zjarrfikësit janë parë në vendin e ngjarjes duke punuar për ta shuar zjarrin. Zjarrin kaploi disa nga zyrat në katin e dytë të ndërtesës së Institutit, si dhe pjesën e çatisë mbi to.

Policia e Kosovës tha se zjarrin në dy zyra të Institutit të Mjekësisë Ligjore në Prishtinë u raportua në orën 8:00 të martën.

Policia doli menjëherë në vendin e ngjarjes dhe tha se zjarrfikësit e kanë lokalizuar zjarrin. Nuk dihet se çfarë mund ta ketë shkaktuar zjarrin në ndërtesën e këtij Instituti. Prokuroria Themelore e Prishtinës dhe policia kanë bërë me dije se i kanë nisur tashmë hetimet “për

sqarimin e plotë të rrethanave që karakterizojnë ngjarjen”.

Instituti i Mjekësisë Ligjore është përgjegjës për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemit mjekoligjor në vend, për të siguruar shërbime mjekoligjore, mësimdhënie dhe shërbime përkrahëse për familjet e personave të zhdukur.

Detyrat e tij përfshijnë, po ashtu, sigurimin e ekspertizës mjekoligjore për organet publike, udhëheqjen e hetimeve mjekësore për vdekjen në vendin e ngjarjes, kryerjen e zvarrosjeve, kryerjen e inspektimeve pas vdekjes dhe kryerjen e autopsive.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka reaguar ndaj zjarrit që përfshiu zyrat e Institutit të Mjekësisë Ligjore të Kosovës në Prishtinë.

Krasniqi ka shkruar në “Facebook” se për të dytën herë brenda një viti Instituti i Mjekësisë Ligjore në Prishtinë po dëmtohet nga zjarre të

dyshimta. “Pas zhdukjes së mostrave të rastit të Astrit Deharit në dhjetor të vitit të kaluar dhe zjarrit të marsit të këtij viti, sot flaka kaploi disa nga zyrat kryesore të këtij Instituti. Nga të gjitha organet kompetente, kërkoj që urgjentisht të hedhin dritë mbi këtë çështje. Ndërkaq, Ministria e Drejtësisë, e cila menaxhon me këtë Institut, duhet të dalë urgjentisht me informata konkrete rreth këtij rasti! Çfarë e shkaktoi zjarrin? Çfarë u dogj dhe cilat janë dëmet? A janë dëmtuar prova dhe mostra të tjera, të cilat do të dëmtojnë hetimin e ndonjë rasti? Si është e mundur që edhe pas zhdukjes së mostrave të rastit Dehari, mbikëqyrja dhe niveli i sigurisë në këtë Institut të mbeten kaq të ulëta?”, ka shkruar Krasniqi.

Ai ka thënë se mungesa e mbrojtjes së Institutit të Mjekësisë Ligjore, edhe pas dështimeve të kaluara, nuk mund të quhet më as

papërgjegjësi dhe as rastësi. “Tashmë, dyshimet janë edhe më të mëdha se, për qëllime të caktuara të pushtetit aktual, ky institut është rikthyer në cak dhe në instrument politik. Dikush duhet të jap përgjegjësi!”, ka shkruar Krasniqi.

Edhe deputeti i pavarur Haki Abazi ka reaguar pas ngjarjes që ndodhi në IML. Ai ka drejtuar akuza se objekti i IML-së është djegur nga vetë pushteti pas marrjes në pyetje të ministres së Drejtësisë, Albulena Haxhiu. “Njëherë e vodhën, tani e dogjën dhe në ndërkohë Ministria e Drejtësisë bën padrejtësinë e shkelje të rëndë, duke degraduar e interferuar me shtyllën e pavarur, nga pozita e ministres dhe në prapaskenë me logon e qeverisë së republikës fyen prokurorin. Deklarata publike pas intervistimit nga prokurori i rastit dëshmon që komunistët nuk besojnë në drejtësinë e pavarur, nuk e durojnë drejtësinë që nuk është sipas dëshirës së tyre. Kjo sjellje dhe ky interferim nga pozita të larta është i rrezikshëm e është i papranueshëm për shoqëritë demokratike. Ky nuk është ndryshimi, ky është vetëvazhdimi!”, ka shkruar Abazi.

Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, ka thënë se pushteti që vjen nga flaka veç flakë prodhon. “Në opozitë të kallnin institucionet, ndaj dhe

në pushtet po u kallen institucionet. Sot, zjarrin ka kapluar ndërtesën e Institutit të Mjekësisë Ligjore. Mos të harrojmë se para pak kohësh zjarrin përfshiu edhe Shërbimin Emergjent në Klinikën e Psikiatrisë të QKUK-së, ku për pasojë pati edhe një viktimë”, ka shkruar Gashi.

Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka bërë me dije se të martën rreth orës 08:00 të mëngjesit, nga drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore, Ditor Haliti, është njoftuar që dy zyra në katin e dytë në objektin e IML-së janë përfshirë nga zjarrin. Sipas saj, ekipet e zjarrfikësve, policia dhe prokuroria menjëherë kanë shkuar në vendin e ngjarjes. “Nga vlerësimet fillestare, nuk ka pasur djegie ose dëmtim të mbetjeve mortore, arkivës së IML dhe mostrave. Ekipet e forenzikës, ekspertët e zjarrit dhe të elektroteknikës janë ende duke e kryer punën e tyre me qëllim që të dihen shkaqet e zjarrit. Policia dhe prokuroria po ashtu janë duke bërë punën e tyre. Për shkak të atyre që kanë ndodhur në IML ndërvite, me të drejtë qytetarët mund të jenë të shqetësuar lidhur me këtë mirëpo pa kuptuar shkakun e zjarrit nuk mund të japim informacione më shumë. Sapo të kemi informacione më të detajuara lidhur me rastin, do të njoftojmë me kohë”, ka shkruar Haxhiu në “Facebook”.

Pilotët e FSK-së nisin programin rifreskues të fluturimit në Shqipëri

Prishtinë, 21 nëntor - Pilotët e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) do të ndjekin një program rifreskimi teorik dhe praktik të fluturimeve nën

nikoqirllëkun e Forcave Ajrore Shqiptare. Për këtë lajm ka shkruar në “Facebook” edhe ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Niko Peleshi. “Forca

Ajrore shqiptare hap dyert për pilotët e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Pilotët e FSK-së do të ndjekin në Bazën Ajrore të Farkës programin e rifreskimit

teorik dhe praktik të fluturimeve me helikopter, i detyrueshëm për ekuipazhet për të mbajtur reflekset e fluturimit”, ka shkruar Peleshi.





Stoltenbergu në Beograd: Grumbullimi i ushtrisë serbe pranë Kosovës s'i ndihmon situatës

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë të martën në Beograd, se të dyja palët duhet t'i ulin tensionet, duke theksuar se grumbullimi i forcave të ushtrisë serbe në afërsi të kufirit me Kosovën nuk ndihmon në qetësimin e situatës së tensionuar mes dy vendeve

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë të martën në Beograd, se grumbullimi i forcave të ushtrisë serbe në afërsi të kufirit me Kosovën nuk ndihmon në qetësimin e situatës së tensionuar mes dy vendeve. "Unë llogaris në të dyja palët për t'i ulur tensionet dhe për t'u përmbajtur nga përshkallëzimi i veprimeve", tha Stoltenbergu në një konferencë për medie me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, të martën paradite. Stoltenbergu mbërriti në Beograd pas një vizite që pati të hënën në Prishtinë, ku theksoi se aleanca

ushtarake po e shqyrton mundësinë nëse duhet të ketë një shtim të përhershëm të pranisë së saj ushtarake në Kosovë pas shpërthimit të dhunës në shtator. Tensionet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë u rritën dukshëm më 24 shtator kur Policia e Kosovës u sulmua nga një grup i armatosur serbësh në fshatin Banjskë të Zveçanit në veri të vendit, ku mbeti i vrarë rreshteri Afrim Bunjaku. Tre sulmues serbë u vranë në luftimet që pasuan. Përgjegjësia për sulmin e 24 shtatorit e mori Millan Radoičiq, ish-nënkryetar i Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë që gëzon mbështetjen e Beogradit. Serbia, në periudhën e kaluar,

disa herë ka vendosur trupa pranë kufirit me Kosovën, kurse herën e fundit i vendosi pas sulmit në Banjskë, por e ka tërhequr ushtrinë pas ndërhyrjes diplomatike të Perëndimit. Stoltenbergu, po ashtu, tha në Beograd se autorët e sulmit në Banjskë duhet të dalin para drejtësisë. "Ne e mirëpresim faktin që Serbia është e gatshme të bashkëpunojë", tha Stoltenbergu në një konferencë të përbashkët për shtyp me Vuçiqin. Stoltenbergu tha se temë e bisedës me Vuçiqin ishte edhe sulmi ndaj pjesëtarëve të KFOR-it gjatë protestës së komunitetit serb në Zveçan në fund të majit. Sekretari i përgjithshëm i NATO-s theksoi se "mirëpret dhe mbështet formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. "Ky do të ishte çelësi i normalizimit të marrëdhënieve. U bëj thirrje Beogradit dhe Prishtinës të angazhohen në dialog nën kujdesin e BE-së. Kjo është e vetmja rrugë drejt paqes dhe stabilitetit të përhershëm", tha ai.

Ai tha se me Vuçiqin ka biseduar edhe për rifillimin e stërvitjeve të përbashkëta të Forcave të Armatosura të Serbisë me forcat e NATO-s. "Kjo nuk cenon neutralitetin e Serbisë. Serbia e ka bërë të qartë se ajo mbetet ushtarakisht neutrale, jashtë blloqeve ushtarake", vlerësoi ai, duke shtuar se Serbia është një aktore e rëndësishme rajonale dhe një partnere afatgjatë e NATO-s dhe se shembull i mirë i bashkëpunimit është pjesëmarrja e Serbisë në programin Partneriteti për Paqe. Serbia ndaloi stërvitjet ushtarake ndërkombëtare pas fillimit të agresionit rus kundër Ukrainës në shkurt 2022. Duke komentuar kërkesën e Perëndimit që Serbia të mos e grumbullojë ushtrinë e saj në kufirin me Kosovën, presidenti serb Aleksandër Vuçiq u përgjigj se ushtria serbe "kurrë nuk i ka tejkalarur të drejtat dhe kompetencat e saj". "E ku dhe si do ta vendosim ushtrinë në përputhje me Kushtetutën e Serbisë, pa rrezikuar askënd, kjo është punë e jona", shtoi ai.

Kur është fjala për hetimin e sulmit në Banjskë, Vuçiqi tha se "ai ka një pikëpamje tjetër për atë që ka ndodhur, por i kupton kërkesat e NATO-s dhe Perëndimit". "Në përputhje me ligjin dhe legjislacionin vendas, ne do t'i mbajmë përgjegjës ata që morën pjesë në kryerjen e veprave penale në Banjskë", shtoi ai. Vuçiqi e cilësoi bashkëpunimin e Serbisë me NATO-n dhe misionin e KFOR-it, të mirë dhe korrekt. Ai, po ashtu, tha se do t'i dërgojë kërkesë Qeverisë së Serbisë që ta shqyrtojë vendimin për të marrë pjesë sërish në stërvitjet e përbashkëta "me NATO-n dhe partnerët e tjerë". Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha në Prishtinë më 20 nëntor se aleanca po shqyrton nëse duhet të ketë një shtim të përhershëm të pranisë së saj ushtarake në Kosovë pas shpërthimit të dhunës në shtator. "Tani ne po shqyrtojmë nëse duhet të kemi shtim të përhershëm për t'u siguruar që kjo të mos dalë jashtë kontrollit

INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-së
SI "ORGANIZATË TERRORISTE"? (9)

Osmani për draft-statutin e Asociacionit: Ka çështje që krijojnë dykuptimësi dhe duhet të sqarohen

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka folur të martën sa i përket draftit të statutit për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Ajo ka thënë se ka çështje që duhet të sqarohen sepse krijojnë dykuptimësi dhe, sipas saj, mund të krijojnë probleme në praktikë. Presidentja ka thënë se që nga fillimi ka qenë tërësisht e paarsyeshme që ky draft të mos ndahen me liderët e opozitës

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka deklaruar se ka çështje që krijojnë dykuptimësi në draft-statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Ajo ka thënë se shpreson se të njëjtat do të eliminohen para se drafti të dërgohet për interpretim në Gjykatën Kushtetuese. Osmani ka thënë se ka përgatitur komentet me shkrim dhe se i ka dërguar tek të gjithë aktorët e përfshirë në përgatitjen e këtij drafti. Këto komente Osmani i ka bërë pas ndarjes së çmimit për "Guxim-Vasfije" për doktorin Shukri Gërxhaliun. Ajo ka thënë para medieve të martën se është kërkesë e emisarëve

ndërkombëtarë që të mos bëhen publike komentet në lidhje me këtë draft-statut. "Në qoftë se drafti procedohet në Gjykatën Kushtetuese, atëherë si presidente e vendit do t'i dorëzoj komentet. Unë kam punuar një analizë të këtij dokumenti. Komentet me shkrim të cilat i kam përgatitur i kanë të gjithë aktorët relevantë që kanë qenë të involuar në përgatitjen e këtij drafti, përfshirë Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ka çështje të cilat patjetër duhet të sqarohen, sepse krijojnë dykuptimësi, rrjedhimisht do të mund të shkaktonin probleme në praktikë. Me shpresën që ato mund të eliminohen edhe në këtë fazë, pra para se të shkojë drafti në Gjykatën Kushtetuese. Mirëpo, në qoftë se



jo, unë jam e bindur që gjykata do t'i sqarojë ato duke u bazuar edhe në interpretimet e vet gjykatës që i ka dhënë në vitin 2015, shumë prej të cilave janë si parime udhërrëfyese tani për çfarëdo asociacioni", ka thënë Osmani. Ajo nuk ka dhënë detaje sa iu përket komenteve të saj, por ka theksuar se është e padrejtë që i njëjti nuk është ndarë edhe me partitë opozitare. "Meqenëse

është kërkesë e vet emisarëve ndërkombëtarë që mos t'i bëjmë publike komentet, pa e bërë ata vetë publik draftin që kanë prezantuar, atëherë do ta respektoj këtë kërkesë. Edhe pse mendoj se që nga fillimi ka qenë e padrejtë dhe tërësisht e paarsyeshme që ky draft mos të ndahet edhe me liderët e opozitës. Ata përfaqësojnë parti politike dhe qytetarë të

Republikës së Kosovës, kështu që si presidente kam insistuar që nga dita e parë që ky draft të ndahet edhe me ta dhe shpresoj shumë që së shpejti ata që janë autorë të këtij dokumenti do ta japin edhe miratimin për një gjë të tillë", ka thënë Osmani. Shefja e shtetit ka theksuar se shumë prej parimeve të vitit 2015 nuk janë të pranishme në draft-statutin euro-amerikan.

Lansohet fushata për imazhin e arsimit dhe aftësimin profesional

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Të martën është lansuar fushata "Mësimi dual: mundësi për punësim dhe vetëpunësim të rinjve", me mbështetje të Deutsche Gesellschaft fuer Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH. Përmes kësaj fushate synohet përgatitja e rinisë sonë për tregun e punës.

Ministria e Arsimit, Arbërie Nagavci, ka ftuar nxënësit të bëhen pjesë e arsimit dual, duke theksuar se në vitin 2021 filluan arsimin dual me tri profile në katër shkolla, ku në tri komuna u regjistruan 107 nxënës. "Këtë vit kemi shtuar edhe 8 profile të reja. Në 12 profilet duale sivjet janë regjistruar 920 nxënës në 21 shkolla profesionale në 14



komuna", është shprehur Nagavci. Ajo ka falënderuar bizneset, grupet punuese, shkollat dhe të gjithë ata e ato që po mundësojnë që arsimit dual sipas modelit të vendeve

gjermanofolëse të jetësuat suksesshëm edhe në Kosovë. Duke u gjendur para kryqëzimit të ndryshimeve globale dhe rritjes ekonomike në vendin tonë, ku kërkohet një fuqi punëtore e aftë, e

adaptueshme dhe inovative, kryeministri Albin Kurti ka theksuar se Arsimit dhe Aftësimi Profesional është thelbësor për mirëqenien sociale. "Kësisoj, bashkëpunimi ynë me qeverinë gjermane tregon rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në ndërlidhjen e arsimit me tregun e punës", ka thënë Kurti. Sipas tij, duke mësuar nga modeli gjerman, qeveria që drejton synon t'i integrojë praktikën më të mira me kontekstin tonë unik. "Një sistem i cili u përgjigjet nevojave të ekonomisë dhe shoqërisë sonë, por edhe potencialeve të vendit tonë. Këtu bashkëpunimi i ngushtë

mes kompanive, shoqatave përkatëse, shkollave profesionale, nxënësve dhe prindërve tonë, është parakusht i çdo përpjekjeje institucionale për ndërtimin e sistemit dual", ka thënë kryeministri Kurti gjatë fjalës së tij. Përmes kësaj fushate kryeministri rekomandoi që kompanitë t'i adresojnë propozimet e tyre te Ministria e Arsimit dhe te shkollat përkatëse në komunat e tyre, ndërkaq odat t'u ndihmojnë kompanive anëtare për mbledhjen e kërkesave që nga viti shkollor 2024/25 të kemi hapësira të mjaftueshme nëpër shkolla profesionale për t'i përgatitur nxënësit.

dhe të krijojë ndonjë dhunë në Kosovë, apo në rajonin e gjerë. Ne do të bëjmë atë që është e nevojshme. Aktualisht ne jemi duke shqyrtuar rregullimet rreth pranisë sonë", tha ai në një konferencë për medie me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani. Gjatë vizitës në Prishtinë,

Stoltenbergu tha se shtimi i pranisë ushtarake në Kosovë me 1 000 trupa - që përbën vendosjen më të madhe në vitet e fundit të aleancës - tregon se sa seriozisht e merr aleanca dhunën që shpërtheu muajt e fundit në Kosovë. "Ne vërtet po investojmë në sigurinë e këtij rajoni, sepse siguria e njerëzve në këtë rajon,

stabiliteti në këtë rajon, ka rëndësi për sigurinë tonë", tha ai. Shefi i NATO-s tha se aleanca është duke kryer një shqyrtim të pranisë ushtarake "që përfshin Bosnjë-Hercegovinën dhe Kosovën". Presidentja Osmani ka theksuar se vizita e sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg në

Kosovë, vjen në një moment përcaktues për paqen dhe sigurinë jo vetëm në rajon, por në të gjithë kontinentin tonë. "Kosova është e vendosur për të ardhmen e saj, prandaj në takimin e sotëm ritheksova rëndësinë urgjente të anëtarësimin në NATO, duke filluar me përfshirjen e vendit tonë në Partneritetin për

Paqe. Në një rajon të sfiduar nga planet destabilizuese të Serbisë, bashkëpunimi me aleatët tanë në NATO është i domosdoshëm për të siguruar paqe dhe siguri afatgjatë në rajon dhe më gjerë", ka deklaruar Osmani. Stoltenbergu gjatë vizitës në Kosovë është takuar edhe me kryeministrin Albin Kurti.

Rinisin punimet në "Rrugën A"

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka bërë me dije se punimet në "Rrugën A" kanë rinisur të martën. "Shkalla e dytë e Gjykatës Komerciale rrëzoi vendimin skandaloz të gjykatës familjare. E rrëzoi

sepse ishte joprofesional; e rrëzoi sepse ishte shkelje e rëndë. Vendimet e urdhëresave politike s'mund të përfundojnë ndryshe. Popullistët, me gjithë mllëfin e urrejtjen që bartin për punën e tjetrit, na humbën veçse kohë. Do të duhej të

kishin brenga tjera, do të duhej të kishin qëllime të tjera; sepse vendi ka nevoja plot. Ne vazhdojmë; ekipit të Kryeqyteti u themi puna e mbarë ju qoftë; e qytetarët e Prishtinës megjithatë nuk do të harrojnë!", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook".



Nxënësit e Prishtinës sjellin në jetë drunjtë në ekspozitën artistike për mbrojtjen e pyjeve

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Në ambientet e Bibliotekës Komunale "Hivzi Sylejmani" në Prishtinë u mbajt ekspozita me titull "Fëmijët sjellin në jetë drunjtë përmes pikturës", pjesë e programit "Mbështetje në fuqizimin e menaxhimit të qëndrueshëm dhe shumë qëllimor të pyjeve për përmirësimin e jetesës në zonat rurale dhe adresimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë".

Sipas një njoftimi për medie, në këtë ngjarje u prezantuan punimet artistike të nxënësve nga katër shkollat fillore të Prishtinës: ShFMU "Nazim Gafurri", ShFMU "Faik Konica", ShFMU "Xhemajl Mustafa" dhe



ShFMU "Elena Gjika". "Ngjarja synoi ta ngrihë ndërgjegjësimin në komunitet rreth rëndësisë së mbrojtjes së mjedisit dhe pyjeve. Programi i FAO-s, së bashku me

mbështetjen financiare nga partnerët, ka kontribuar për ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe adresimin e sfidave të ndryshimeve klimatike në

Kosovë", thuhet në njoftim.

Po në njoftim bëhet me dije se drejtori i Departamentit të Pylltarisë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Tahir Ahmeti, ka theksuar rëndësinë e ngjarjes, duke deklaruar se kjo është një shfaqje e ngritjes së vetëdijes dhe ndikimit për ndryshim ndaj qasjes së pyjeve.

Ai tha se për prodhimin e oksigjenit për një njeri duhen vetëm katër drunjtë të ahut.

Olivier Boudart, nga Zyra e BE-së në Kosovë, ka uruar artistët e rinj. "Është vërtet e mahnitshme nga cilësia dhe bukuria e vizatimeve dhe pikturave tuaja. Pyjet janë një burim kyç i planetit tonë, ndërsa ju keni

zgjedhur që të na kujtoni këtë përmes pikturës", ka pohuar Boudart.

Pjesëmarrësit shprehën gatishmërinë të punojnë drejt një të ardhmeje më të qëndrueshme në fushën e pyjeve dhe mbrojtjes së mjedisit. FAO, në bashkëpunim të vazhdueshëm me partnerët e saj, vazhdon të marrë masa të përbashkëta për ta promovuar menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve pyjore dhe për ta inkurajuar pjesëmarrjen aktive të komunitetit. Këto përpjekje synojnë ta frymëzojnë dhe fuqizojnë komunitetin për të ndërtuar një të ardhme më të qëndrueshme në fushën e pyjeve dhe mbrojtjes së mjedisit.

Përurohesh hapësirat e rinovuara të Lavatores së Spitalit të Prizrenit

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Elvir Azizi, drejtor i përgjithshëm i ShSKUK-së, dhe dr. Narqize Arënliu-Hoxhaj, drejtoreshë ekzekutive e Spitalit të Përgjithshëm "Dr. Daut Mustafa" në Prizren, të martën kanë përuar hapësirat e rinovuara të Lavatores së Spitalit të Përgjithshëm "Dr. Daut Mustafa" në Prizren.

Dr. Narqize Arënliu Hoxhaj, drejtoreshë ekzekutive, ka falënderuar drejtorin e ShSKUK-së për mbështetjen për realizimin e këtij projekti si dhe menaxhmentin dhe të gjithë aktorët që kanë punuar për realizimin e këtij projekti shumë të rëndësishëm. "Falënderoj drejtorin e ShSKUK-së për



mbështetjen e realizimit të këtij projekti, por edhe projekteve të

tjera në spital. Renovimi i Lavatores ishte një nga projektet e

identifikuara në fillim të marrjes së mandatit, sepse kur e kam vizituar për herë të parë, pashë se kushtet e punës ishin jo të mira dhe pajisjet ishin shumë të vjetra dhe me defekte të shpeshta. Jam shumë e lumtur që sot bashkërisht po përurojmë Lavatoren e spitalit me ambient, pajisje dhe kushte shumë më të mira të punës dhe që do të ndikojnë në ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore", ka thënë drejtoresha e spitalit.

Elvir Azizi, drejtor i përgjithshëm i ShSKUK-së, ka përgëzuar drejtoreshën dhe menaxhmentin e spitalit të Prizrenit për realizimin e këtij projekti, i mbështetur edhe nga ShSKUK-ja, por edhe punën që është duke u bërë në Spitalin e Prizrenit, duke premtuar përkrahje edhe për projekte të

tjera, që do të jenë në të mirë të qytetarëve për marrjen e shërbimeve shëndetësore. "Jemi të përkushtuar dhe do t'i përkrahim projektet dhe investimet në ShSKUK me të gjitha njësitet përbërëse, me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira për punë, ngritjen e cilësisë së shërbimeve dhe besueshmërinë e qytetarëve për marrjen e shërbimeve shëndetësore. Ne si ShSKUK kemi përkrahur edhe këtë projekt, që do të jetë në shërbim të ngritjes së cilësisë në Spitalin e Prizrenit", ka thënë drejtori Azizi.

Projekti ka kushtuar mbi 250 mijë euro. Në të përfshihen: renovimi i tërësishëm i objektit, furnizimi me makina të larjes, makina tharëse, hekurosje dhe inventar përcjellës.

Gjoha për qytetarët që hedhin mbeturina në parkun "Te pishat" në Sllatinë

Fushë-Kosovë, 21 nëntor - Komuna e Fushë-Kosovës ka njoftuar se do të gjobiten të gjithë ata qytetarë që hedhin mbeturina në parkun rekreativ "Te pishat" në Sllatinë. "Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit në vazhdimësi ka bërë pastrimin e

hapësirave publike, me theks të veçantë hapësirave në parkun rekreativ "Te pishat" në Sllatinë. Lusim qytetarët që të jenë më të përgjegjshëm për mirëmbajtjen e mjedisit dhe t'i hedhin mbeturinat në shporta apo në kontejnerë", thuhet në njoftimin e komunës.

Në njoftim është thënë se të gjithë duhet të jemi më miqësorë me mjedisin që ta ruajmë shëndetin tonë. "Personat të cilët hedhin mbeturina jashtë shportave dhe kontejnerëve do të dënohen me gjoha mandatore nga Inspektorati Komunal", thuhet në njoftim.



Kosova, nikoqire e Federatës Evropiane të Gazetarëve

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës (AGK) ka njoftuar se Kosova për herë të parë do të jetë nikoqire e Federatës Evropiane të Gazetarëve (EFJ) për takimin vjetor të kësaj organizatës i cili do të mbahet në maj të vitit 2024. Takimi vjetor i EFJ-së do të organizohet nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, në

kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë. “Ky takim do të shënojë një moment historik të rëndësishëm për AGK-në dhe organizata është e gatshme për të organizuar një event të madh. Është një moment i jashtëzakonshëm në historinë e re 20-vjeçare të AGK-së, që t’i besohet një organizim kaq i madh. Ne do të mirëpresim vitin e

ardhshëm në Prishtinë qindra gazetarë nga mbarë Evropë, për të diskutuar çështje të rëndësishme që lidhen me sigurinë e gazetarëve në kontinentin tonë, dhe do të jetë mundësi edhe për ta treguar mikpritjen e jashtëzakonshme për të cilën njihet shteti ynë”, ka thënë kryetari i AGK-së, Xhemajl Rexha.



Ministria e Jashtme: Asnjë shtetas i Kosovës nuk ndodhet në Gazë

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës (MPJD) tha të martën se asnjë shtetas i Kosovës nuk ka jetuar dhe nuk ndodhet në Rripin e Gazës tani, enklavën palestineze e cila është duke u përballur me sulme të vazhdueshme izraelite tash e shumë javë. Izraeli i nisi bombardimet dhe pastaj një ofensivë tokësore në Gazë më 7 tetor si përgjigje ndaj sulmeve të Hamasit - grupit radikal palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara në qytetet e Izraelit jugor, ku u vranë mbi 1 200 njerëz dhe u rrëmbyen rreth 240 të tjerë. Ministria e Jashtme tha për “Radion Evropa e Lirë” se në bazë të informatave të konfirmuara të Ambasadës së Kosovës në Jerusalem, “asnjë shtetas i Kosovës nuk ka jetuar dhe nuk ndodhet në këto

momente në Gaza”. Mbi 12 700 njerëz janë vrarë në Gazë gjatë sulmeve izraelite prej 7 tetorit, sipas Ministrisë së Shëndetësisë së Gazës, e cila udhëhiqet nga Hamasi. Evakuimi i shtetasve të huaj dhe palestinezëve me shtetësi të dyfishtë, përfshirë të plagosurit rëndë nga Gaza përmes pikëkalimit kufitar me Egjiptin, Rafah, nisi më 1 nëntor. Deri më tani janë evakuuar mijëra njerëz, përfshirë 11 shtetas të Shqipërisë. Ndërkohë, MPJD njoftoi se deri më tani 10 kosovarë janë evakuuar nga Izraeli, të gjithë në ditët e para të konfliktit. “Ambasada e Republikës së Kosovës në Izrael ua ka ofruar të gjithëve mundësitë dhe lehtësirat e nevojshme për t’u larguar nga vendi në ditët e para të konfliktit”, tha MPJD. Por, ajo shtoi se tanimë



fluturimet e organizuara janë ndërprerë dhe “eventualisht secili duhet t’i gjejë mundësitë individualisht për t’u larguar”

nga Izraeli. Ambasada e Republikës së Kosovës në Izrael vazhdon të mbajë kontakte të rregullta me të

gjithë shtetasit e mbetur në territor dhe konfirmohet se gjendja e tyre në përgjithësi është e mirë, sipas MPJD-së.

Ambasadori i Shqipërisë bën homazhe në Prekaz dhe viziton familjen e ish-presidentit Rugova



PRISHTINË, 21 NËNTOR - Ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Petrit Malaj, ka bërë homazhe në Prekaz dhe ka vizituar familjen e ish-presidentit Ibrahim Rugova.

Ambasadori Malaj ka shprehur respekt për pritjen që i është bërë nga familja Jashari në Prekaz. “Kam bërë homazhe pranë varrezave të dëshmorëve në



Prekaz, ku përzemërsisht vendosa një kurorë me lule në shenjë respekti për gjakun e derdhur nga familja Jashari për lirinë e Kosovës, liri që gëzojnë

pasardhësit e tyre sot, si dhe vizitova familjen e Komandantit Legjendar Adem Jashari, ku u prita dhe u ndjeva shumë i respektuar nga kryefamiljari z.

Rifat Jashari. Mirënjohje dhe faleminderit për mikpritjen baca Rifat! Gjithashtu vizitova familjen e presidentit të parë të Kosovës, Ibrahim Rugova, i shoqëruar nga bashkëshortja ime dhe stafi diplomatik i Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Prishtinë. Me nderim e respekt të thellë për figurën dhe kontributin historik të dr. Ibrahim Rugovës, i shpreha bashkëshortes së Presidentit dhe djemve të tij vlerësimin maksimal për vizionin, qëndresën, bashkëpunimin e tolerancën që karakterizonte këtë burrë shteti. Familja Rugova mbetet mike e çmuar e Ambasadës së Shqipërisë në Kosovë”, ka shkruar ambasadori Malaj në “Facebook”.

Miratohet në parim Projektligji për Mbrojtjen nga Zjarri

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, drejtuar nga kryetari Bekë Berisha, shqyrtoi të martën Projektligjin për Mbrojtje nga Zjarri. Me këtë rast, pas

miratimit në parim, lidhur me këtë projektligj u formua edhe grupi i punës. Komisioni, po ashtu, shqyrtoi edhe Projektligjin mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së

Kosovës për vitin 2024 nga fushëveprimi i komisionit. Lidhur me këtë Komisioni u pajtua të mbajë sërish një takim tjetër gjatë javës së ardhshme. Në këtë mbledhje u shqyrtuan edhe një sërë

çështjesh dhe projektligjesh që bien në fushëveprim të Komisionit si dhe u diskutua nga përfaqësues të grupeve punuese ecuria e procesit të punës në amendamentimin e projektligjeve. Me theks të

veçantë, një diskutim i gjerë u zhvillua edhe rreth Projektligjit për Agjencinë e Sigurisë dhe Mbrojtjes, pas prezantimit të kryetarit të grupit punues, Enver Dugolli.

Kurti: Rritja ekonomike këtë vit pritet të jetë 3.8 %

Prishtinë, 21 nëntor - Kryeministri Albin Kurti ka thënë të martën se qarkullimi i ekonomisë ka pasur një rritje të jashtëzakonshme. Sipas tij, nga 12.56 miliardë euro në vitin 2019, në 18.15 miliardë euro në vitin 2022, një rritje prej 44.5 %. “Të hyrat nga taksat në periudhën 2020-2022 u rritën 47 %, pa e ndryshuar politikën fiskale. Në fushën e tregtisë ndërkombëtare, eksportet tona në vitin 2022 arritën në 920.4 milionë euro, pothuajse duke u dyfishuar

krahasuar me vitin 2020. Jemi në rrugën e duhur për të tejkaluar 1 miliard euro eksporte këtë vit, një arritje që nënvizon dinamikën e ekonomisë dhe të eksportit tonë”, ka thënë ai. Kryeministri Kurti ka pohuar se raporti eksport-import ka pësuar përmirësime të ndjeshme, duke kaluar nga pothuajse 1:9 në vitin 2019, në më pak se 1:6 sa është aktualisht. Sipas tij, ky është një tregues i qartë i rritjes dhe diversifikimit të ekonomisë

sonë. “Investimet në vendin tonë kanë qenë të fuqishme, me investimet e huaja direkte që janë dyfishuar për dy vjet. Vetëm në vitin 2022 ne regjistruam 772 milionë euro në Investime të Huaja Direkte, në total prej 1.2 miliard eurosh për dy vitet e fundit. Rritja jonë ekonomike në vitin 2022 ishte 5.2, dhe për vitin 2021 në një nivel impresiv prej 10.7 %. Ndërkaq këtë vit duket se do të mund ta përmbyllim me një rritje ekonomike prej 3.8 %”, ka deklaruar Kurti.



Raporti për komunat dhe MSh-në: Nga 27 tenderë, për 13 prej tyre ka pasur ankesa në OShP



PRISHTINË, 21 NËNTOR - Në prezantimin e “Raportit të monitorimit të prokurimit”, në të cilin janë të përfshirë 27 tenderë, për 13 prej tyre ka pasur ankesa në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OshP). Sipas një njoftimi për medie, bëhet me dije se raporti është bërë nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Demokraci Plus në kuadër të projektit “Mbështetja e OJQ-ve për të monitoruar aktivitetet e prokurimit në komuna dhe MSh-së”. “Raporti përfshin monitorimin e 27 tenderëve, duke përfshirë tre në Ministrinë e Shëndetësisë dhe tre për secilën nga komunat: Gjakovë, Gjilan, Lipjan, Pejë, Prishtinë, Rahovec, Suharekë dhe Vushtrri. Monitorimi është kryer në tri fazat kryesore: fazën e para-tenderimit, tenderimit, dhe pas-tenderimit. Procesi i monitorimit ka përfshirë analizën dhe grumbullimin e

dokumentacionit, inspektim në terren, dhe biseda me aktorët e rëndësishëm”, thuhet në njoftim. Bëhet me dije se gjetjet e raportit tregojnë se komunat dhe Ministria e Shëndetësisë vazhdojnë të kenë sfida për të përmbyllur një proces të prokurimit pa shkelje të Ligjit dhe Rregullave të Prokurimit Publik: “Që nga faza e parë e planifikimit të prokurimit e deri në menaxhimin dhe zbatimin e plotë të një kontrate janë evidentuar shkelje”. Në tryezën e prezantimi të raportit, një fjalë rasti ka mbajtur edhe Maia Gogoladze, drejtoreshë e aktivitetit të USAID-it - Integriteti i Komunave. “Jam shumë e lumtur që jam këtu. Kemi menduar që do të jetë shumë e rëndësishme që të ndajmë me ju gjetjet, rekomandimet e BIRN dhe D+ me mediet, institucionet dhe

qytetarët”, ka thënë Gogoladze. Gjatë prezantimit të raportit, Visar Prebreza nga BIRN-i ka thënë se nga 13 nga 27 tenderët e monitoruar apo në 48 % prej tyre ka pasur ankesa në Organin Shqyrtues të Prokurimit. “Për këta 13 tenderë ishin bërë 32 ankesa në OShP, prej të cilave 15 ishin refuzuar dhe në 13 prej tyre ishin aprovuar pretendime të OE-ve ankesues. Nga 13 vendime në të cilat OShP-ja kishte gjetur shkelje ligjore, 12 prej tyre ishin shkelje të bëra gjatë fazës së ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderëve”, ka deklaruar ai gjatë prezantimit të raportit. Një prej shkeljeve më të shpeshta që është evidentuar gjatë këtij monitorimi ka qenë vendosja e kriterëve diskriminues, kriterëve shumë të larta për projektin apo emërimi i produkteve dhe prodhuesve që janë kërkuar. Një nga gjetjet e raportit evidenton

se komunat e monitoruara në masë të madhe nuk kanë qenë në gjendje t'i tregojnë emrat e personave që i kanë hartuar specifikat teknike. “Vetëm MSh ka treguar emrat e personave që i kanë hartuar specifikacionet teknike për tre nga tenderët e monitoruar”, thuhet në raport. Tryeza bëri bashkë përfaqësues të institucioneve publike përgjegjëse për prokurimin publik në vend, të shoqërisë civile dhe medieve, të cilët diskutuan në lidhje me gjetjet e raportit. Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit, Vjosa Gradinaj-Mexhuani, ka deklaruar se sfida kryesore e OShP-së është mungesa e anëtarëve të bordit dhe numri i lartë i ankesave. “Vitin e kaluar gjatë gjithë vitit kanë qenë 820 ankesa, ndërsa këtë vit deri tani janë 940 ankesa”, ka pohuar Gradinaj-Mexhuani. Ndërsa kryetari i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik,

Osman Vishaj, ka theksuar se dy prej hallkave më të dobëta të procesit të prokurimit janë planifikimi dhe menaxhimi i kontratave. “Cikli i prokurimit është sikur hallkat e një zinxhiri. Dy hallkat më të dobëta janë planifikimi dhe monitorimi i kontratave apo menaxhimi i kontratave. Çka e dëmton procesin është edhe informatat që u jepen operatorëve ekonomikë paraprakisht. Përzgjedhja e procedurës ka shumë rëndësi, por kësaj nuk i jepet shumë rëndësi”, ka potencuar Vishaj. I pranishëm në këtë tryezë ishte edhe ushtruesi i detyrës së shefit të Divizionit të Prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë, Berat Marmullaku. Ai ka përmendur njëherë nga masat që është duke ndërmarrë MSh-ja për penalizim të kompanive që nuk e zbatojnë kontratën sipas kushteve të parapara.

Vërshimet që tronditën Kosovën, procesohen pagesat për rreth 2 000 familje të prekura

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se, pas përfundimit të procedurave të nevojshme nga ana e komunave dhe komisionit përkatës për

vlerësimin dhe verifikimin e dëmeve, tashmë janë procesuar pagesat në kuadër të mbështetjes për rimëkëmbje nga dëmet e vërshimeve në ekonomitë

familjare, për vërshimet më 2022 dhe 2023. “Sipas vendimit të qeverisë dhe vlerësimit të komisioneve përkatëse, gjithsej janë mbështetur 1 905 familje, nga

to për vërshimet e shtatorit 2022 janë 620 familje të mbështetura, kurse për vërshimet e janarit 2023 janë 1 285 familje të mbështetura”, ka shkruar Murati në “Facebook”.



Sfidë Perëndimit. Çfarë duan vendet e BRICS?



Milena GABANELI

Bota “jo-perëndimore” ngre nivelin e sfidës ndaj hegjemonisë ekonomike dhe financiare të Shteteve të Bashkuara. Nga 1 janari 2024, gjashtë vende, Irani, Arabia Saudite, Egjipti, Argjentina, Emiratat e Bashkuara Arabe dhe Etiopia, do t’i bashkohen grupit “Brics”, ku tashmë bëjnë pjesë Brazili, Rusia, India, Kina dhe Afrika e Jugut. Do të jetë hapi i parë në një lloj “big bang”-u, që aspiron të ndryshojë ekuilibrin gjeoekonomik të botës. Të paktën 40 shtete të tjera kanë kërkuar tashmë t’i bashkohen klubit, nga Algjeria në Indonezi, nga Kuba në Kazakistan në Gabon.

Kështu po formohet një koalicion që bashkon fuqitë e mëdha, si Kina, India dhe Rusia, me vendet afrikane, aziatike dhe afrikano-jugore, që janë ende në zhvillim. Ky mesazh u përcoll edhe në samitin e së mërkurës më 15 nëntor midis liderit kinez Xi Jinping dhe presidentit amerikan Joe Biden në San Francisko. “Bota – tha Xi – është mjaft e madhe për të dy ne. Kina dhe Shtetet e Bashkuara janë plotësisht të afta për rritje, pavarësisht dallimeve të tyre”. Me fjalë të tjera: dyert e hapura për kapitalin perëndimor, por konkurrencë e gjithanshme me Uashingtonin për primatin global.

Lindja e Briks

Akronimi Bric u krijua në vitin 2001 nga Jim O’Neill, kryeekonomist i bankës amerikane të investimeve Goldman Sachs, për të treguar katër realitete mbi të cilat duhet fokusuar për investime me potencial të lartë, duke pasur parasysh zhvillimin e tyre të trazuar. Parashikimi i O’Neill, në realitet, nuk mori parasysh se po fillonte edhe një proces politiko-diplomatik. Qeveritë e Brazilit, Rusisë, Indisë dhe Kinës kishin

filluar tashmë një dialog i cili arriti pjekurinë me samitin e parë, të organizuar në jug të Rusisë, në Yekaterinburg, më 16 qershor 2009. Në vitin 2010, katër themeluesit vendosën të hapen drejt Afrikës së Jugut. Dhe kështu Bric u bënë Brics.

G7 dhe BRICS

Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) vë në dukje se në vitin 2022 pesë vendet e Brics prodhuan 31.5% të produktit bruto botëror. Nga janari i ardhshëm, me shtimin me 11 shtete, pjesa e pasurisë totale do të vazhdojë të zgjerohet: 38.5% në 2028.

Sa për të pasur një pikë krahasimi: në vitin 2022 Bashkimi Evropian mbuloi 14.5% të PBB-së botërore; ndërsa G7, 30.3%. Dhe në vitin 2028 pjesa e tyre e pasurisë do të reduktohet më tej: ajo e BE-së (13.7%), ajo e G7 (27.7%). 1.03 miliardë njerëz jetojnë në bllokun G7-BE, 3.6 miliardë në “Brics plus”. G7 mund të llogarisë rezerva ari prej 17,527 ton, Brics ka 5,493 ton. Por ato vendet “e reja” kanë tashmë 21% të stokut të naftës dhe me ardhjen e Arabisë Saudite, Emiratave të Bashkuara Arabe dhe Iranit do të arrijnë pragun e 41%. Në frontin perëndimor, dy prodhuesit e vetëm, përkatësisht Shtetet e Bashkuara dhe Kanadaja, kanë vlerë respektivisht 20 dhe 6%. Por çështja është: cilat janë objektivat, ku duan të shkojnë “Brics plus” dhe mbi të gjitha, a mund të shkojnë.

Objektivat

Qëllimi i tyre i shpallur është të ndërtojnë një rend ekonomik, tregtar dhe financiar alternativ ndaj atij të krijuar nga Shtetet e Bashkuara në fund të Luftës së Dytë Botërore.

Hapi i parë tashmë është hedhur: krijimi i “Bankës së Re për

Zhvillim” (Nbd). Ajo filloi të funksionojë në vitin 2016, nga selia e saj në Shangai, me ambicien për t’u bërë fondi monetar për vendet në zhvillim: duke u dhënë hua qeverive në vështirësi, pa kërkuar reforma drastike. Aksionerët e Bankës janë pesë shtetet e Brics, të cilëve u janë shtuar Egjipti, Bangladeshi dhe Emiratat e Bashkuara Arabe.

Në shtatë vjet aktivitet, NDB-ja ka shpenzuar ekuivalentin e 30 miliardë dollarëve për të financuar rreth 100 projekte në lidhje me infrastrukturën, me synimin për të arritur në 350 miliardë deri në vitin 2030, duke parakaluar FMN-në, e cila në 15 nëntor 2023 po menaxhon rreth 110 miliardë dollarë kredi. Nbd lëviz kryesisht monedhat vendase, si pjesë e një strategjie më të gjerë: për të hequr qafe “diktaturën e dollarit”.

Një monedhë alternative për dollarin

Kjo temë ishte në qendër të samitit të fundit të Brics, më 24 gusht 2023, në Johannesburg, në Afrikën e Jugut. Xi Jinping, Lula, Modi, ministri rus Sergei Lavrov, presidenti i Afrikës së Jugut Cyril Ramaphosa u nisën nga fakti që dollari është sot pikë qendrore. Monedha amerikane rregullon 60% të tregtisë ndërkombëtare dhe 89% të transaksioneve në tregun valutor, pra blerjen ose shitjen e valutës. Ndërsa emetimet e obligacioneve ndërkombëtare të shprehura në dollarë kanë shkuar nga 38.5% në 2003 në 48.5% në 2023. Kjo do të thotë se në njëzet vitet e fundit gjithnjë e më shumë shtete dhe gjithnjë e më shumë kompani publike apo individë janë mbështetur në monedhën amerikane, për të kërkuar burime në tregjet e huaja financiare. Por a do të ishte vërtet në gjendje

“Brics plus” të lançonte një monedhë të vetme, ndoshta sipas modelit të euros, të konceptuar dhe testuar nga e para? Përgjigja e përhapur në qarqet globale financiare është “jo”; dhe kështu do të jetë për një kohë të gjatë.

Pekini kandidon juanin

Ndërkohë, qeveria e Pekinit po shtyn të caktojë monedhën e saj, juanin, për t’u bërë alternativë ndaj monedhës amerikane. Por është shumë mbrapa: sot juani mbulon vetëm 2.6% të rezervave valutore botërore, krahasuar me 5.8% të jenit japonez, 4.8% të paundit britanik, 20% të euros dhe 59% të dollarit.

Që nga viti 2005, Pekini ka lidhur një sërë marrëveshjesh me bankat qendrore, ndër të tjera, të Malajzisë, Argjentinës dhe Nigerisë për të ofruar juanin si monedhë për rezervat valutore. Për më tepër, kinezët kanë zhvilluar një platformë bankare, së bashku me Tajlandën, Hong Kongun dhe Emiratat e Bashkuara Arabe, për t’u përdorur si një alternativë ndaj Swift-it, sistemi më i përdorur nga institucionet globale të kreditit për të shlyer pagesat financiare dhe tregtare. Megjithatë, India dhe Indonezia tashmë kanë bërë të ditur se nuk janë të interesuara të zëvendësojnë dominimin e dollarit me atë të juanit. Ndërsa presidenti brazilian Lula propozon: “Kur tregtojmë me njëri-tjetrin, mund ta bëjmë lehtësisht duke përdorur monedhat tona”.

Harta e tregtisë botërore

Ideja e Lulës, megjithatë, mund të ketë një ndikim të kufizuar. Duke filluar nga gjigantët, Kina dhe India. Në vitin 2022, trafiku mes dy vendeve u rrit me 8.2%, duke arritur pragun e 135.9 miliardë

dollarëve.

Tregtia ndërmjet SHBA-së dhe Indisë arriti në 191.8 miliardë dollarë; ajo mes SHBA-së dhe Kinës është deri 758.4 miliardë. Prandaj, të testuar nga faktet, Brics nuk janë ende në gjendje të bëjnë pa Shtetet e Bashkuara dhe Perëndimin, produktet e tij, teknologjinë e tij dhe monedhën e tij referuese. Atëherë çështja politike mbetet: është e vështirë të imagjinohet që këto 11 vende dhe ato që do të vijnë mund të lëvizin në një mënyrë kompakte, dhe për këtë arsye të ndikojnë në diskutimet në organet ndërkombëtare, ose në G20, grupi që mbledh periodikisht liderët e 20 ekonomitë më të mira në planet.

Kina nuk e ka dënuar në mënyrë eksplicite agresionin e Putinit në Kiev. India e bëri. Mosmarrëveshjet kufitare kombëtare midis Pekinit dhe Nju Delhit janë të vazhdueshme.

Xi Jinping synon të zvogëlojë ndikimin amerikan në rajonin Indo-Paqësor. Nga ana tjetër, kryeministri indian Modi po kultivon dialogun me Joe Biden.

Për Lindjen e Mesme: Irani dëshiron të fshijë Izraelin nga faqja e dheut; Arabia Saudite ishte e gatshme të firmoste një marrëveshje bashkëpunimi ekonomik me Tel Avivin, në këmbim të mbrojtjes ushtarake të Uashingtonit, si dhe teknologjisë amerikane për përdorim civil. Reagimi izraelit ndaj sulmit terrorist në Gaza, megjithatë, ka bashkuar, të paktën për momentin, botën myslimane kundër qeverisë së Benjamin Netanyahu.

Sfidat e «Brics plus», pra, do të jenë dy. Ajo drejt Perëndimit dhe paralelisht ajo e nivelimit të dallimeve të brendshme politike, për të ndarë strategjinë për paranë, tregtinë, investimet për të vënë në pikëpyetje qendrën gjeoekonomike perëndimore. / *corriere della sera – bota.al*

Asllani për 'Mediaset': Itali - Shqipëri? Do të ishte bukur

Tiranë, 21 nëntor - Futbollisti i Interit, Kristjan Asllani, ndien keqardhje që eliminatorët e Shqipërisë nuk u mbyllën me tri pikë, por është shumë i lumtur që në pjesëmarrjen e parë ia doli

të kualifikohej. Pas ndeshjes me Ishujt Faroe, mesfushori kuqezi për "Mediaset" foli edhe për një përplasje të mundshme me Italinë në "Gjermani 2024". "Gjeja e parë që bëra pasi përfundoi

ndeshja ishte të shihja se çfarë kishte ndodhur me Italinë. Jam shumë i gëzuar për djemtë, për ata që luajnë me mua tek Interi dhe për të gjithë italianët. E meritojnë kualifikimin. Po, është

kjo mundësia e përplasjes, do të ishte bukur, por Italia është shumë e fortë. Për ne është hera e dytë. Duhet të përshtatem dhe ta japim më të mirën", ka deklaruar Asllani.



Më 2 dhjetor Shqipëria mëson kundërshtarët e 'Euro 2024'

TIRANË, 21 NËNTOR - Shqipëria ka arritur për herë të dytë që ta sigurojë vendin e saj në një Kampionat Evropian (hera e parë më 2016), pasi në vitin 2024 do të jetë në Gjermani. Kombëtarja kuqezi, e udhëhequr nga trajneri Sylvinho, e ka siguruar kualifikimin në turneun madhështor, duke e mbyllur fazën kualifikuese si lidere e grupit. Tani sytë janë kthyer te përcaktimi i kundërshtarëve që kombëtarja do të përballë në këtë event që shumë e presin me padurim. Zbulimi i ekipeve kundërshtarë pritet të bëhet së shpejti, pasi shorti për "Euro 2024" është caktuar të mbahet më 2 dhjetor. UEFA ka planifikuar ta organizojë ceremoninë në këtë datë në orën 18:00 në Hamburg, gjatë së cilës do të përcaktohet rrugëtimi jo vetëm i ekipeve të kualifikuara, por edhe atyre që janë ende në pritje të pjesëmarrjes, pasi në mars do të luajnë në raundin e "play-off"-it. Shorti do të realizohet duke lënë hapur tre vende për skuadrat e "play-off"-ve, të cilat do të konfirmohen zyrtarisht si pjesëmarrëse në turne vetëm pasi



të kenë përfunduar ndeshjet e tyre në mars.

Një detaj interesant është se Gjermania, si vend pritës, është e vetmja skuadër që e ka të

garantuar grupin. Gjermanët do të jenë automatikisht në Grupin A si ekipi i parë, duke u siguruar kështu që ta luajnë ndeshjen hapëse të turneut më 14 qershor 2024.

Golden State u rikthehet fitoreve, zhgënjën Bostoni

SAN FRANCISCO, 21 NËNTOR - Milwaukee bëhet forca e tretë në Konferencën e Lindjes pas fitores me rezultat 142-129 ndaj Washingtonit. Të gjithë titullarët e Bucksit realizuan mbi 15 pikë, ku u dallua Giannis Antetokounmpo, autor i 42 pikëve e 13 reboundeve. Zhgënjën skuadra e Bostonit, që u mund me shifrat 121-118 në fushën e Charlottes pas kohës shtesë, por ruan kreun e klasifikimit në Lindje. Tatum realizoi 45 pikë e 13 rebounde për Celticsin, por që s'mjaftuan për të fituar, ndërsa për Charlotten shkëlqeu LaMelo Ball me 36 pikë.



Fitore të rëndësishme korrën clippersat, që mundën San Antonion (124-99). Stoli ishte vendimtar për Clippersin, nga erdhën 54 pikë. Rikthehet te fitorja

pas 6 humbesh radhazi ekipi i Golden States, që mundi me rezultat 121-116 Houstonin. Rikthimi i Curryt, vendimtar për Warriorsin, autor i 32 pikëve.

REZULTATET

Charlotte - Boston	121-118
Detroit - Denver	103-107
Washington - Milwaukee	129-142
Chicago - Miami	100-118
Minnesota - New York	117-100
New Orleans - Sacramento	129-93
San Antonio - Clippers	99-124
Golden State - Houston	121-116

SHKURT

KB Prishtina rikthen Malcolmmin

KB Sigal Prishtina e ka rikthyer në radhët e veta basketbollistin Malcolm Armstead. "Bardhekaltrit" e kanë zyrtarizuar fundorin amerikan, i cili do t'i mbrojë ngjyrat e klubit kryeqytetas deri në fund të këtij sezoni. Armstead së fundmi ishte pjesë e Golden Eagle Yllit dhe e Pejës, ndërsa u rikthye në klubin ku luajti në vitin 2019. Ai llogaritet lojtar vendor pasi e ka pasaportën e Kosovës. Me Pejën në këtë edicion i kishte 11 paraqitje në krejt garat me një mesatare prej 6,6 pikësh për ndeshje.

Nagelsmann: Gjermania nuk ia ka frikën asnjë rivali

Gjermania nuk po kalon nëpër një formë aspak të mirë, por kur është në pyetje shorti për Kampionatin Evropian nuk janë aspak të shqetësuar. Të paktën kështu ka bërë me dije trajneri Julian Nagelsmann. "Sigurisht që nuk shqetësohem më për skuadrat që do të kemi përballë. Jemi përpjekur t'i gjejmë kundërshtarët e duhur në rrugëtimin drejt Kampionatit Evropian. S'ia kam frikën asnjë rivali. Ne duam të fokusohemi dhe të japim më të mirën, pjesa tjetër i takon fushës", ka thënë Nagelsmann.

Silhavy jep dorëheqje pasi e kualifikoi Çekinë në 'Euro 2024'

Jaroslav Silhavy nuk do të jetë më trajner i Republikës Çeke, pasi ka dhënë dorëheqjen pas kualifikimit në "Euro 2024". Silhavy mori drejtimin në shtator të vitit 2018 dhe udhëhoqi Çekinë në çerekfinalet e "Euro 2020". Ata, gjithashtu, rezervuan vendin e tyre për në Kampionatin Evropian verën e ardhshme, duke mposhtur ditën e hënë Moldavinë me rezultat 3-0. "Edhe pse jemi të lumtur tani, ne kishim vendosur tashmë para ndeshjes që të mos vazhdonim më aventurën së bashku. E informova presidentin Petr Fouska për këtë vendim. Presioni ishte i madh tashmë, ndonjëherë as që e kuptoja. Kjo gjë kontribuoi në vendimin tonë", ka thënë tekniku 62-vjeçar.

Leao mungon kundër Dortmundit

AC Milan pritet të jetë pa yllin Rafael Leao në ndeshjen e tyre të ardhshme në Ligën e Kampionëve ndaj Borussia Dortmundit. Kuqezinjtë aktualisht janë në vendin e tretë në Grupin F pas katër ndeshjeve, duke marrë vetëm pesë pikë, një më pak se Paris Saint-Germain dhe dy më pak se Dortmundi. Me dy ndeshje të mbetura për të luajtur, të katër skuadrat kanë një mundësi për t'u kualifikuar në fazën eliminatorë të kompeticionit kryesor të Evropës për klube. Siç raportohet nga "Calciomercato", rikuperimi i Leaos nuk ka shkuar ashtu siç pritej në Milanello dhe tani klubi pret që ai të mos jetë në ndeshjen ndaj Dortmundit më 28 nëntor.

Dalin në ankand fanellat e Messit që ka veshur në Kupën e Botës në Katar

Një grup prej gjashtë fanellash të veshura nga Lionel Messi në Kupën e Botës 2022 në Katar do të dalin në ankand në dhjetor. Shtëpia e ankandëve Sotheby


vlerëson vlerën e tyre në më shumë se 10 milionë dollarë. Messi i veshi fanellat me vija bardheblu në ndeshjet e grupeve kundër Arabisë Saudite dhe

Meksikës, më pas në 1/16 kundër Australisë, në çerekfinale kundër Holandës, në gjysmëfinale kundër Kroacisë dhe në finale kundër Francës. Kapiteni i

atëhershëm 35-vjeçar i Argjentinës fitoi titullin kampion botëror që i mungonte. Kompania shpreson të marrë më shumë se 10 milionë dollarë për

koleksionin, i cili do të shitet online nga 30 nëntori deri më 14 dhjetor dhe do të jetë i ekspozuar publikisht në selinë e Sotheby's në Nju-Jork.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Kosova U21 mposhti Izraelin

Prishtinë, 21 nëntor - Përfaqësuesja e Kosovës U21 u është rikthyer fitoreve në kualifikueset për "Euro 2025". U21-shat triumfuan në stadiumin "Zahir Pajaziti" të Podujevës ndaj Izraelit me rezultatin 3-1. Tri gola u

shënuan në pjesën e parë, një në të dytën. Figura kryesore e "dardanëve" të rinj ka qenë futbollisti Bleron Krasniqi, i cili i shënoi dy gola. Fillimisht, Bleroni realizoi golin për t'i zhbllokuar shifrat në minutën e gjashtë. Pas katër minutash

sërish Krasniqi shënoi, këtë herë për 2:0. Në minutën e 24-t mysafirët arritën t'i ngushtojnë shifrat me anë të Stav Nahmanit për 2:1. Në pjesën e dytë Kosova U21 arriti që në 10 minutat e fundit të kohës së rregullt ta vulosë fitoren. Autor

ishte Veton Tusha i cili realizoi për 3:1 dhe rezultatin final. Pas kësaj fitoreje, Kosova tash grumbullon tetë pikë për pozitën e tretë. Prej tyre ka dy fitore, dy barazime e po aq humbje. Ndeshjen e radhës Kosova e luan vitin e ardhshëm,



më saktësisht në muajin mars në udhëtim te Gjermania U21.

Kosova me humbje i mbyll eliminatoret për 'Euro 2024'

"Epoka e re"

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll me humbje i mbylli kualifikimet për Kampionatin Evropian "Euro 2024", pasi në stadiumin "Fadil Vokrri" pësoi humbje nga Bjellorusia (0-1). "Faleminderit lojtarëve, pasi luajtën shumë mirë të gjithë në këto tri ndeshjet e fundit, por pa sulmues klasik është vështirë. Gjyqtari nuk na dha një penallti. Patëm shumë raste, nuk i konkretizua. Patëm barazim me Andorrën dhe humbje me Bjellorusinë paraprakisht. Aty bëmë gabim", ka thënë pas ndeshjes Primoz Gliha, trajner i Kosovës. "Dardanët" që nga fillimi i ndeshjes ishin më tepër në zotërim të topit dhe tentuan vazhdimisht të gjejnë rrugën e golit, por nuk arritën të finalizojnë asnjë prej mundësive të krijuara. Rastet më të mira i patën Bytyqi, Berisha e Rashani. Në anën tjetër, bjellorusët në gjuajtjen e parë drejt portës



arritën të gjejnë golin. Ishte minuta e 43-të, kur Dmitri Antilevski realizoi gol me gjuajtje nga distanca, kur përfitoi nga

grushtimi i topit nga Visar Bekaj. Në pjesën e dytë sërish "dardanët" u munduan me të gjitha forcat për të ndryshuar

rezultatit, por fusha e rënduar dhe mbrojtja e ngjeshur e mysafirëve nuk lejoi që ata të arrijnë një gjë të tillë. Kësisoj,

Kosova e mbylli këtë cikël kualifikues në pozitën e 5-të në Grupin I, me 11 pikë, një më pak se Bjellorusia e vendit të katërt.

Peja dhe Trepçën sonte zhvillojnë sfidat e fundit në grupet e FIBA Europe Cup



MITROVICË, 21 NËNTOR - KB Peja dhe KB Trepça sonte (e mërkurë) do t'i kenë ndeshjet e fundit në grupet e FIBA Europe Cup. Peja do të përballet me skuadrën polake PGE Spojnia Stargard, që e kishte mundur si mysafir me rezultat 79:83. Kampionët e Kosovës dhe skuadra polake kanë nga dy fitore e tri humbje dhe është dueli direkt për vendin e dytë. FIBA Europe Cup ka njoftuar se nga

dhjetë grupe, liderët dhe gjashtë më të mirat nga vendet e dyta do të kualifikohen tutje. Niners është kualifikuar si lider me pesë fitore në pesë ndeshje, kurse Peja mund të kualifikohet me fitore si e dyta, por varet edhe nga skuadrat e tjera të dyta në grupet e tjera. Rezultatet me vendet e fundit në grup nuk merren parasysh për kualifikim tutje. Ndërkohë, mitrovicasit do të përballen me

BCM Gravelines Dunkerque. "Xehetarët" nuk kanë gjasë për kualifikim, pasi kanë tri humbje në tri ndeshje, ndërsa francezët kanë dy fitore e një humbje. Lider është ZZ Leiden me tri fitore e një humbje.

Orari

19:00 Trepça - BCM Gravelines Dunkerque
19:00 Peja - PGE Spojnia Stargard


Kurshumlja dhe Mumini delegohen në ndeshjen e rëndësishme të FIBA Europe Cup Women

PRISHTINË, 21 NËNTOR - FIBA Instruktori Nacional dhe Komisar i Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Faton Kurshumlja dhe gjyqtari i njohur, Xhelal Mumini, janë të deleguar në

ndeshjen Galatasaray - Union Factoring - Angers. Kurshumlja do të jetë vëzhgues në këtë sfidë, ndërsa Mumini gjyqtar, njofton FBK-ja. Kjo sfidë

është shumë e rëndësishme, pasi Galatasaray është në vendin e parë me katër fitore në katër ndeshje, kurse Unioni me tri fitore dhe vetëm një humbje. Përballja është e rëndësishme për

grupet e FIBA Europe Cup Women. Kurshumlja dhe Mumini kanë qenë të deleguar edhe në sfidat e tjera evropiane në këtë edicion dhe kanë përvojë nga garat ndërkombëtare.



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Emri i biznesit B5 Inframain SH.P.K. si dhe me emër tregtar B5 Infrastructur&Maintance me Numër Unik Identifikues: 811574583, ka marr vendim për zvogëlim të kapitalit nga 2000.000 në 20.000 Euro.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Rent a Car Alberti&Roni SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues 811356262.

- Denis Canosoji shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V shfmu "Leke Dukagjini" Prizren.

- Arben Gashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VI shfmu "Leke Dukagjini" Prizren.

- Ibrahimhaki Danjoli shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Elvis Kabashaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu "Dëshmorët e Hasit" Kabash i Hasit.

- Urim Khanemi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Imer Himaj nga Osek Hyla KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, të sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë Transport Rrugorë.

- Bedri Nezaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klm I, II të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Fisnik Kumnova nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Mjekësisë Gjakovë.

- Ferdane Alidemaj shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Fazli Greicevci".

- Ubejd Gashi shpall te pavlefshme diplomën e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës me nr. të diplomës 4157.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për

info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë



D P A
Departamenti për punë administrative

Mitrovicë 22.11.2023 / Nr. 1668

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë, shpallë këtë:

K O N K U R S

(Për plotësimin e vendit të punës, punë provuese gjashtë (6) muaj me mundesi vazhdimi)

I. Pozita e punës: Drejtor Komercial.

Kompania: Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë.
Paga bazë: 991.25 Euro, sipas Rregullores mbi ndarjen e të ardhurave të KRU "Mitrovica".

Kushtet për punësim (edukimi i kërkuar):

Përgatitja profesionale: Titulli "Master", në drejtimet (Ekonomik, Menaxhment, Administrim Biznesi).

Përvoja e punës: Tri (3) vite përvojë pune, prej tyre së paku dy (2) vite punë menaxheriale
Pozita e hapur: Një (1) Drejtor Komercial.

Kushtet e veçanta:

- ✓ Njohuri të larta të raportimit të performancës dhe proceseve financiare/buxhetore,
- ✓ Të jetë shumë i orientuar drejt qëllimeve dhe zotëroj aftësi të shkëlqyera ndër personale dhe komunikuese,
- ✓ Aftësi të shkëlqyera organizative dhe udhëheqjes,
- ✓ Njohja e punës me kompjuter, programe softuerike (aplikacione) që funksionojnë në kuadër të Ndërmarrjes.

Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

- Të jetë i/e aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës,
- Drejton, organizon dhe zbaton punët dhe detyrat e caktuara në kompani në Departamentin Komercial si dhe të Marrëdhënies me konsumatorët dhe çështjet specifike (Faturimi, Inspektimi),
- Udhëheq dhe këshillon gjithë personelin vartës për të siguruar rezultate efektive,
- Drejton dhe përgatitë të dhënat komerciale të kompanisë për planin e biznesit,
- Shqyrton dhe aplikon procedurat e aprovuara për sektorin komercial,
- Koordinon, kontakton dhe bashkëpunon në ofrimin e të gjitha të dhënave të aktivitetit të departamentit ne varësi,
- Analizon klimën e treguesve dhe tendencat e biznesit ne aspektin komercial për të ndihmuar drejtuesit e lartë në krijimin e planeve strategjike për të ardhmen,
- Interpretin informacionin sektorial për të siguruar raportet e nevojshme për vendim-marrje,
- Monitoron procesin e faturimit dhe shitjeve, nivelin e performancës në njësit vartës, llogaritë e arkëtueshme,
- Sipas autorizimeve të KE-se përfaqëson Ndërmarrjen përpara palëve të interesit,
- Sipas kërkesave përpilon raporte mujore dhe vjetore për ARRU dhe institucione qeveritare,
- Është pjesë ndërlidhëse midis departamentit dhe njësitë e tjera,
- Kryen detyra të tjera, me ZKF-ne koordinon aktivitetet rreth mirëmbajtjes së llogarive të arkëtueshme dhe kryen detyra të caktuara nga Kryeshefi Ekzekutiv, sipas fushës së kompetencës dhe pozitës,
- Për punën që e kryen i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

Dokumentet e kërkua:

Kandidatet e interesuar duhet të plotësojnë aplikacionin e Kompanisë dhe së bashku me këtë aplikacion të bashkangjesin edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Letër motivimi,
- Diploma e Universitare (kopja e noterizuar, kurse diploma nga universiteti jashtë vendit duhet të jetë e nostrifikuar),
- Dëshmia nga gjykata kompetente që nuk është nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj,
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale,
- Dëshmi mbi eksperiencën e punës,
- Një deklaratë nën betim (për pozitën: Drejtor Komercial).
- Kopja e letërnjoftimit.

Aplikacionet mund të merrën ueb-faqën e Kompanisë KRU "Mitrovica" Sh.A. në adresën: <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset/>, si dhe në zyrën për burime njerëzore dhe të dorëzohen në të njëjtën zyrë së bashku me dokumentacionin përcjellës në formë fizike.

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit nga data **22.11.2023** deri me datën **06.12.2023**.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të mangëta refuzohen.

Dokumentet e pranuar të aplikantëve në fotokopje nuk kthehen.

Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë inkurajon kandidatet femra, kandidatet nga grupet minoritare si dhe personat me aftësi të kufizuar të aplikojnë.

KRU "Mitrovica" Sh.A. Mitrovicë.



D A P

Departament za Administrativne Poslove

Mitrovica 22.11.23 Br 1668

Na osnovu Administrativnog uputstva br. 07/2017, Regionalno vodovodno preduzeće "Mitrovica" d.d. u Mitrovici, objavljuje:

K O N K U R S

(Za popunjavanje radnih mesta probni rad u trajanju od šest (6) meseci, sa mogućnošću produženja)

I. Radno mesto: Komercijalni Direktor.

Kompanija: Regionalna Kompanija Vodovod „Mitrovica“ D.D. u Mitrovici.

Osnovna plata će biće 991.25 Euro po uredbi o raspodeli prihoda.

Uslovi za zapošljavanje (potrebno obrazovanje)

Stručna sprema: Maester (Ekonomija, Menadžment, Poslovna Administracija)

Radno iskustvo: 3 godina radnog iskustva, od kojih najmanje 2 godine menadžerski

Otvorena pozicija: Jedan (1) Komercijalni Direktor.
posebni uslovi;

- ✓ Visoko poznavanje izveštavanja performanse i finansijskih/budžetskih procesa,
- ✓ Da bude veoma orijantisan ka cilju i imati odlične međuljudske komunikacijske veštine,
- ✓ Odlične organizacione i rukovodeće sposobnosti,
- ✓ Poznavanje rada sa kompjuterom, softverskim programima (aplikacije) koje funkcionišu u okviru Preduzeća.

Radne obaveze i odgovornosti:

- Da bude sposoban/na za obavljanje radnih obaveza sa punim radnim vremenom i bez ograničenja,
- Da usmerava, organizuje i realizuje poslove i zadatke u preduzeću u Sektoru Komercijale, kao i donose sa potrošačima i specifična pitanja (fakturisanje, inspekcija sa potrošačima),
- Da vodi i savetuje svo podređeno osoblje kako bi osigurali efektivne rezultate,
- Da upravlja i pripremi komercijalne podatke kompanije za poslovni plan,
- Da pregledai procenjuje odobrene procedure za komercijalni sektor,
- Da koordinira, kontaktira i saraduje u pružanju svih podataka o aktivnostima pdrđenog odeljenja,
- Da analizira komercijalnu klimu i poslovne trendove marketinških stručnjaka kao bi pomogli višim rukovodiocima u kreiranju strateških planova za budućnost,
- da tumači sektorske informacije kako bi obezbedio neophodne izveštaje za donošenje odluka,
- Da prati proce fakturisanja i prdaje, nivo učinka u podređenim jedinicama, potraživanjima,
- Da po ovlašćenjima EK zastupa Preduzeće pred zainteresovanim strankama,
- Da prema zahtevima izradi mesečne i godišnje izveštaje za ARRU i vladinih institucija,
- Da je deo za vezu između odeljenja i drugih jedinica,
- Da izvrši druge zadatke, sa ZKF koordinira aktivnosti oko održavanja potraživanja i da završi određene zadatke od strane glavnog Izvršnog Direktora, prema oblasti nadležnosti i položaja,
- Za poslove koje izvršava odgovara izvršnom Direktoru.

Traženi dokumenti:

Zainteresovani kandidati moraju da popune prijavu Kompanije i da uz ovu prijavu prilože sledeću dokumentaciju:

- CV (biografija),
- Motivaciono pismo,
- Univerzitetska diploma (overena kopija, dok diplome sa univerziteta u inostranstvu moraju biti overene kod notara),
- Dokaz nadležnog suda koji nije pod istragom, koji važi najviše 6 meseci,
- Dokaz o stručnoj obuci,
- Dokaz o radnom iskustvu,
- Izjava pod zakletvom (za poziciju: komercijalni direktor).
- Kopija lične karte,

Prijave se primaju na sajtu Preduzeća RVP „Mitrovica“ d.d. na adresi <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset/> kao i u kancelariji za ljudske resurse i dostavlja se istoj kancelariji zajedno sa pratećom dokumentacijom.

Konkurs će biti ovoren 15 dana od dana objavljivanja u sredstvima informisanja pcevsi od dana 22.11.2023 do 06.12.2023.

Prijave podnete nakon roka se ne prihvataju, a nepotpune se odbijaju.

Prihvataena fotokopirana dokumenta podnosiocima prijava se ne vraćaju. Regionalno vodovodnopreduzeće „Mitrovica“ d.d. u Mitrovici podstiče kandidatkinje, kandidate iz manjinskih grupa, kao i osobe sa invaliditetom da se prijave. RVP „Mitrovica“ d.d. Mitrovica.

